



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.9, datë 08.11.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “ERA HYDRO” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Mosmiratim me arsyetimin që të shtyhet vendimarrja deri sa subjekti të shlyej detyrimet financiare që ka të lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Era Hydro”, me adresë Njësia Administrative Pishaj Gramsh Qarku Elbasan sipas Miratimit Paraparak me Nr. 3647/5, datë 03.07.2017 “Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Blineta”, në lumin e Tomorricës, me derdhje në lumin Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”, si dhe shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së miratimit paraparak për hidrocentral “Blineta” me anë të shkresës me Nr. 9718/1 Prot., datë 17.01.2019 “Mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Miratimit Paraparak për hidrocentral “Blineta””. për shoqërinë “Era Hydro”.
2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:
HEC Blineta
 - Prodhimi vjetor i parashikuar: 7.521.000 kwh/vit
 - Fuqia e instaluar: 1.980 kwh

- Vlera totale e investimit: 399,418,456 lekë me TVSH.
Vendndodhja e veprës së marrjes/ burimi ujqor Lumi i Tomorricës

- X= 517253.6; Y= 4515878.08; Z=262 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 7.5 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 5.7 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 1.21 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.6 m³/s

Vendndodhja e Godinës së Centralit

- X= 515638.06; Y= 4520827..84; Z=213 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 7.5 m³/s

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

